

Njoftimi i përqendrimit me të cilin Triglav asistencë shëndetësore, shoqëri për veprimtari shëndetësore, d.o.o., Slloveni fiton kontrollin mbi ESKULAP, shoqëri për shërbime shëndetësore, d.o.o., Slloveni

(lënda nr. 08-9/2024)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 09.01.2024, te Komisioni i mbrojtjes së konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit me të cilin Triglav asistencë shëndetësore, shoqëri për veprimtari shëndetësore, d.o.o., me seli në Dunajska cesta 22, 1000 Lubjanë, Slloveni do të fitoj kontrollin mbi ESKULAP, shoqëri për shërbime shëndetësore, d.o.o., me seli në rrugën Redelonghijeva 12, 1000, Lubjanë, Slloveni, përmes shitblerjes së pjesëve.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit

Triglav asistencë shëndetësore, shoqëri për veprimtari shëndetësore, d.o.o., është një shoqëri e kontrolluar nga zavarovalnica Triglav, d.d., dhe e cila së bashku me shoqëritë e tjera përbëjnë Grupin e Kompanive Triglav („Grupi Triglav“)

Zavarovalnica Triglav është shoqëri mëmë e fundit e Grupit Triglav. Grupi Triglav është një grup udhëheqës sigurimesh dhe financiare në Slloveni dhe rajonin e Adria dhe një nga grupet kryesore në Evropën Juglindore.

Grupi operon në shtatë tregje dhe gjashtë vende. Për më tepër, ajo operon në një mjedis më të gjerë ndërkombëtar përmes partneriteteve me kompanitë e huaja të ndërmjetësimit dhe agjencive të sigurimeve, si dhe me ri-siguruesit.

Biznesi kryesor i asistencës shëndetësore Triglav, shoqëri për veprimtari shëndetësore, d.o.o., është ofrimi i asistencës mjekësore dhe veprimtarive tjera mjekësore.

Grupi Triglav ka tre shoqëri të lidhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

1. Triglav Sigurimi SHA Shkup me NVAS 4691130 me adrese bul. 8 shtatori nr. 16 Shkup me veprimtari prioritare - Sigurimi jo jetësor
2. Triglav Sigurimi jo-jetë AD Skopje me NVAS 7233825 me adresë në Bul. Shtator 8 nr. 18/kati 2, me aktivitet prioritari – sigurimit jetësor, dhe
3. Shoqëria Pensionale Triglav SHA Shkup me NVAS 7344228 me seli në Bul. 8 shtatori nr.18 18/kati 2, me prioritet aktivitet – veprimtaritë e administrimit të fondeve

Shoqëria për shërbime shëndetësore, ESKULAP d.o.o., kryen shërbimet si një ordinancë pediatrie në bazë të koncesioneve të marra.

Shoqëria për shërbime shëndetësore, ESKULAP d.o.o., nuk ka shoqëri të lidhura, filiale apo degë të regjistruara në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe as nuk ka gjeneruar ndonjë të ardhur në vitin 2022 në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Parashtruesi i njoftimit vlerëson se si tregje relevante për përqendrimin në fjalë mund të përcaktohen: tregu i shërbimeve mjekësore dhe/ose nënndarjet e tij në shërbime të ndryshme të specializuara ose departamente mjekësore dhe në tregun e sigurimeve shëndetësore (aksident dhe sëmundje) ose në ndonjë treg potencial më të ngushtë.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

11.01.2024

Shkup